



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E FINANCAVE

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT**  
**DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BUXHETIT**

Nr. 18/172 Prot

Tiranë, më 24.12/2015

**Drejtuar:** BASHKIA \_\_\_\_\_

DEGËS THESARIT \_\_\_\_\_

**Subjekti:** Funksionet e reja për vitin 2016

Në zbatim të nenit 15 të ligjit nr.147/2015 "Për buxhetin e vitit 2016", pjesë e transfertës specifike për vitin 2016, janë fondet për funksionet e reja të transferuara në bashkitë përkatëse. Ju bëjmë me dije se, për shkak të implementimit të ndryshimeve të reja funksionale në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë me kompaninë "Oracle", regjistrimi i buxhetit të njërive të qeverisjes vendore për grantin e pakushtëzuar dhe transfertat specifike për çdo funksion, do të rregjistrohen në sistem duke filluar nga data 6 janar 2016. Njësitë e qeverisjes vendore janë të detyruara të përdorin fondet e akorduara si transfertë specifike, sipas tabelës 3 të ligjit, si kosto për personelin administrativ/shpenzime operative për çdo funksion i cili transferohet nga ministria përkatëse. Këto fonde do të jenë pjesë e planit të buxhetit për vitin 2016.

Meqenëse ligji nr.147/2015 "Për buxhetin e vitit 2016", dekretuar me dekretin e Presidentit nr.9376 datë 24.12.2015, nuk ka hyrë në fuqi, deri në hyrjen në fuqi të tij për të siguruar një proces normal të zbatimit të tij, në zbatim të udhëzimit të posaçëm nr.34 datë 28.12.2015 "Për zbatimin e buxhetit të viti 2016", nëpërmjet Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë do të kryen pagesat për pagat dhe sigurimet shoqërore për çdo funksion, pjesë e transfertës specifike të njërive të qeverisjes vendore për vitin 2016.

Pagat e personelit administrativ të muajit dhjetor 2015 për çdo funksion të transferuar te bashkitë, të cilat iu shpërndahen punonjësve në muajin janar 2016, do të jenë sipas numrit dhe strukturës të rakorduar me ministrinë përkatëse.

Sipas nenit 37 të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", në rast të mosmiratimit nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore të buxhetit vendor, deri në ditën e parë të vitit buxhetor, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore autorizon të kryhen çdo muaj shpenzime deri në 1/12 e shpenzimeve faktike të buxhetit vendor në vitin buxhetor paraardhës, për të siguruar vazhdimin e ofrimit të të mirave dhe të shërbimeve, përfshirë zbatimin e projekteve të investimeve, të filluara në vitin buxhetor paraardhës dhe që vazhdojnë në vitin buxhetor.

Për funksionet e reja, të cilat kalojnë te bashkitë sipas tabelës 3 të ligjit nr.147/2015 "Për buxhetin e vitit 2016", si shpenzime faktike të vitit paraardhës do të merren të dhënat të cilat janë në këtë tabelë duke i shumëzuar ato me 95 për qind, për arsye se shpenzimi faktik i vitit të kaluar për këto funksione ka qenë 95 për qind e shumave që janë aktualisht në këtë tabelë.

Lutemi, marrjen e masave për sa më sipër, për të vijuar normalisht me zbatimin e buxhetit të vitit 2016.

Me respekt,

